



TË KUPTOJMË BUXHETIN E SHTETIT

NJË GUIDË E SHKURTËR PËR TË MËSUAR
MË SHUMË RRETH PROCESIVE BUXHETORE
NË NIVEL QËNDROR DHE VENDOR



Budget
Accountability
and Transparency



Funded by
the European Union

Kapitulli 1 – Cfarë është buxheti i shtetit?

Çdo individ dhe familje i planifikon shpenzimet në bazë të shumës së parave që ka në dispozicion. Me fjalë të tjera, një familje, e llogarit koston e jetesës së saj sipas një buxheti – të ardhurave që merr dhe të cilat mund t'i shpenzojë për t'u ushqyer, për t'u veshur, për të paguar qiranë, për t'u argëtuar etj. Ky plan bëhet për periudha të caktuara, për shembull, shpenzimet e familjes mund të llogariten për një periudhë 15-ditore apo për një muaj.

Buxheti është dokumenti (shprehur në terma financiarë) që përmban propozimet e shpenzimeve dhe të të ardhurave të shtetit për një periudhë kohe të caktuar. Ai pasqyron prioritetet e qeverisë.

Në të njëjtën mënyrë, edhe qeveria i planifikon shpenzimet e saj në varësi të buxhetit që harton. Që në vitin paraardhës ajo programon sesa nga të ardhurat e saj do të shpenzohen për nevoja të ndryshme të shtetit si për shembull, për pagat e punonjësve të administratës, për pensionet, për spitalet, për arsimin, për mbrojtjen e vendit etj. Ndryshe nga buxheti i familjes, buxheti i qeverisë planifikohet për një periudhë të caktuar që quhet “vit buxhetor”. Ky vit përbëhet nga 12 muaj dhe sipas standardeve të vendosura në vendin tonë është i njëjtë me vitin kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor.

Ndonëse në koncept është e njëjta gjë, procesi i hartimit, paraqitja dhe miratimi i buxhetit të shtetit për një vit është më i komplikuar sesa përgatitja e buxhetit të familjes apo e atij personal. Ai mbështetet në analizat për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit dhe përputhet me politikat afatgjata të qeverisë.

Kapitulli 2: Të kuptojmë institucionet buxhetore

Ashtu sic në një familje ndahen rolet dhe detyrat (kush bën çfarë), ashtu edhe institucionet kanë role të ndara – pra çfarë kanë për detyrë të bëjnë.




Qytetarët kanë nevojë për shërbime të ndryshme, si për arsim, shërbime shëndetësore etj - prandaj është e nevojshme që të kemi institucione përkatëse të cilat i mbulojnë këto shërbime. Shpesh në lajme ose në media dëgjojmë të përmenden institucione të ndryshme si psh: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Arsimit dhe e Sportit, Kryeministria, Bashkia Tiranë, etj.

Përsa i përket organizimit, sistemi i administratës shtetërore përbëhet nga tre grupe institucionesh:

Administrata qendrore - ku përfshihen Kryeministria, Ministrinë, Institucionet në varësi të Kryeministrit ose të ministrave, etj.

Administrata lokale e qeverisjes vendore – ku përfshihen Bashkitë dhe njësitë e varësisë

Autoritetet e pavarura – janë institucione publike që nuk marrin urdhëra, porosi apo këshilla nga asnjë organizëm tjetër publik




Kapitulli 3: Koncepti “Të ardhura” dhe “Shpenzime”

Disa nga shpenzimet që ka një familje për një periudhë të caktuar janë të një natyre të përhershme si për shembull, qiraja e shtëpisë apo faturat e energjisë elektrike dhe të ujit, ndërsa disa shpenzime të tjera mund të kryhen në varësi të preferencave individuale, për shembull, sa do të harxhohet për të blerë rroba të reja,

për të shkuar në kinema, për të drekuar apo darkuar në restorante etj. E njëjta gjë ndodh edhe kur vjen fjala për shpenzimet që kryen qeveria. Disa prej tyre janë të përhershme si për shembull, pagesa e pensioneve, ndihma ekonomike për të papunët, për shërbimet shëndetësore etj. Ndërsa disa të tjera varen nga planet dhe strategjia e qeverisë, si për shembull shpenzimet për ndërtime, rikonstruksione, për investime në infrastrukturë, në bujqësi, për modernizimin e mbrojtjes së vendit etj. Këto shpenzime ndryshojnë në sasi dhe në lloj, në varësi të prioriteteve që ka qeveria në kohë të ndryshme.

Ashtu si shpenzimet e një familjeje mbulohen kryesisht nga pagat e familjarëve apo nga të ardhura të tjera nga biznese të ndryshme me të cilat merret ajo, edhe qeveria ka burimin e vet të “parave”. Të ardhurat e qeverisë sigurohen kryesisht nga **taksat** dhe **tatimet** mbi aktivitetet e individëve apo të bizneseve private. Qeveria mbledh të ardhura nga individët dhe nga bizneset në formën e tatimeve dhe taksave. Tatimet janë të detyrueshme dhe periodike, dhe llogariten mbi shitjen e prodhimeve apo shërbimeve, mbi të ardhurat personale, mbi fitimin e bizneseve, në formën e sigurimeve shoqërore e shëndetësore etj. Taksat nga ana tjetër, paguhen për shërbimet publike që sigurohen nga qeveria. Këto ndahen në taksa kombëtare dhe taksa vendore.




Pra, qeveria mbledh nga individët të ardhura në formën e tatimeve dhe taksave dhe paguan po prapë individët në formën e pensioneve, të ndihmës ekonomike, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore etj.

Kështu, sa më të mëdha të jenë të ardhurat, aq më të mëdha janë edhe mundësitë për investime nga ana e shtetit. Dhe kur kjo rritje e aktivitetit ekonomik bëhet realitet, thuhet se ekonomia po lulëzon. Prej saj përfitojnë jo vetëm individët – të cilët mund të gjejnë punë më lehtë, mund të paguhen më mirë etj., por

edhe bizneset, fitimet e të cilëve janë më të mëdha. Nga ana tjetër, rriten dhe shumat që paguajnë njerëzit për të ardhurat apo për fitimet që marrin, duke sjellë shtimin e të ardhurave të qeverisë. Dhe cikli vazhdon drejt arritjes së një ekuilibri të dëshiruar.

Kur diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve është pozitive kemi te bëjmë me **suficit** ndërsa e kundërta është situata e **deficitit** – pra kur shpenzimet janë më të larta se të ardhurat buxhetore.

Kapitulli 4: “Odiseja” e hartimit, zbatimit dhe raportimit të buxhetit



Planifikimi Fillestar i Buxhetit

- Ky është hapi i parë, ku fillon puna për buxhetin e ri. Në këtë fazë, qeveria dhe institucionet përkatëse mendojnë për nevojat financiare dhe qëllimet që duan të arrijnë gjatë vitit të ardhshëm. Ata mbledhin informacion nga të gjitha departamentet për të kuptuar sa para do të nevojiten dhe për çfarë qëllimesh

Parashikimi i të Ardhurave

- Pasi të jenë mbledhur të dhënat fillestare, bëhet parashikimi se sa të ardhura (para) do të gjenerohen gjatë vitit. Ky parashikim bazohet në burime të ndryshme të ardhurash si taksat, tarifafat dhe burimet e tjera që qeveria kontrollon. Ky hap është i rëndësishëm, pasi vendos bazën për të kuptuar sa para mund të shpenzohen.

Formulimi i Pr/buxhetit, rishikimi i tij

- Në këtë fazë, qeveria dhe ekspertët hartojnë një version të parë të buxhetit, të quajtur projektbuxhet. Ky buxhet ndan paratë e pritura për sektorë të ndryshëm, si arsimit, shëndetësia, mbrojtja, etj. Synohet të sigurohet që çdo sektor të marrë burimet që i nevojiten për të përmbushur detyrat e veta. Pasi të jetë hartuar projektbuxheti, ai i paraqitet organeve të ndryshme për shqyrtim. Në këtë fazë, bëhen diskutime dhe rishikime për të siguruar që buxheti të jetë i drejtë dhe të përputhet me prioritetet kombëtare. Ky është një proces ku palët e ndryshme kanë mundësi të japin mendimet e tyre dhe të propozojnë ndryshime.

Miratimi i buxhetit

- Kur të gjithë janë dakord me projektbuxhetin dhe ndryshimet e nevojshme janë bërë, buxheti final miratohet nga parlamenti. Kjo do të thotë që buxheti tani është ligjërisht i detyrueshëm dhe qeveria mund të fillojë ta zbatojë atë.

Ekzekutimi i buxhetit

- Pasi buxheti të jetë miratuar, fillon ekzekutimi i tij. Kjo fazë përfshin shpërndarjen e fondeve për departamentet dhe projektet e ndryshme sipas planit të miratuar. Institucionet përgjegjëse fillojnë të përdorin këto fonde për të financuar aktivitete dhe shërbime të ndryshme publike

Monitorimi i zbatimit të buxhetit

- Gjatë vitit, bëhet monitorimi i vazhdueshëm i mënyrës se si po përdoren fondet. Ky monitorim ndihmon për të siguruar që paratë po shpenzohen sipas planit dhe për të identifikuar çdo problem që mund të lindë. Nëse ndonjë sektor shpenzon më shumë ose më pak se sa ishte parashikuar, mund të bëhen rregullime.

Tani që morët më shumë informacion se çfarë është buxheti, e kuptoni më mirë rëndësinë që ka planifikimi i tij. Ai është dokumenti më i rëndësishëm i qeverisë pasi reflekton politikat e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit.

Kapitulli 5: Buxhetimi në nivel vendor

Ashtu sic ndodh buxhetimi në nivel qendror nga Ministritë dhe institucionet e tjera buxhetore, ashtu edhe bashkitë ndjekin të njëjtat hapa por me disa ndryshime në momente të caktuara gjatë këtij procesi. Gjithashtu edhe aktorët e përfshirë në këtë proces ndryshojnë.

Për ta bërë më të kuptueshëm si proces, mendojeni Bashkinë ku ju jetoni si një mini qeveri. Kryetari i Bashkisë do të ishte Kryeministri, anëtarët e Këshillit bashkiak do të ishin deputetët, Këshilli Bashkiak do të ishte një parlament në nivel vendor etj. Gjatë përgatitjes së buxhetit, Bashkia ka detyrimin të reflektojë kërkesat e qytetarëve të saj dhe t'i përkthejë ato në shërbime dhe investime për zonën që mbulon.

A e dini se ju mund të bëheni pjesë e rëndësishme e hartimit të buxhetit?

Ju mund të përfshihen në dëgjесat publike si dhe mund të ngrini shqetësimet dhe problematikat tuaja si individë të komunitetit.

Këshilli Bashkiak dhe Kryetari i Bashkisë kanë detyrimin për të zhvilluar dëgjesa publike për projekt-buxhetin dhe paketën fiskale. Këto janë dy dokumente ku njëri shpjegon se si do shpenzohen paratë ndërkohë paketa fiskale cakton se sa do paguajnë qytetarët taksa dhe tarifa.

Që në dhjetorin e vitit paraardhës, Këshilli Bashkiak miraton kalendarin e buxhetit, ku tregon afatet e hartimit të buxhetit për vitin e ardhshëm.

Procesi fillon në periudhën shkurt-mars, ku Këshilli miraton tavanet përgatitore, pra vendos se sa fonde do i caktojë cdo programi buxhetor. Pra, tavanet/limitet maksimale të shpenzimeve që vendosen në Mars, do të detajohen gjatë vitit në zëra konkret.

Periudha e dytë e konsultimit të buxhetit është muaji Qershor, ku konsultohet drafti i parë i PBA-së, pra për periudhën tre vjecare në mënyrë më të detajuar. Psh për këtë vit, në Qershor 2022, Këshilli Bashkiak konsulton PBA 2023-2025. Ndërsa faza perfundimtare ndodh pikerisht në periudhën Nëntor - Dhjetor ku buxheti pothuaj ka marrë formën përfundimtare.

Zakonisht Bashkia zhvillon takime në të gjitha njësitë administrative ku marrin pjesë Kryetari i Bashkisë, Drejtori i Financës si edhe keshilltarë. Po kjo nuk është rruga e vetme që ju mund të ndiqni për të kërkuar një investim të caktuar nga Bashkia. Këshilli Bashkiak ka nje rregullore të posacme per peticionet, duke krijuar një të tillë i cili mund ti përcillet Këshillit Bashkiak për shqyrtim.


Këshilli Bashkiak shpall kalendarin e dëgjesave publike me datën dhe vendin ku do mbahen dëgjesat ku të gjitha grupet janë të ftuara të marrin pjesë. Sa më shumë përfshihen duke ngritur shqetësimet dhe nevojat tuaja, aq më shumë rriten mundësitë që të merren në konsideratë këto kërkesa në muajin dhjetor kur zhvillohet mbledhja e Këshillit Bashkiak që miraton buxhetin e Bashkisë...

Çdo qytetar apo grupe që përfaqësojnë komunitetet kanë të drejtë te drejtojnë kërkesa, ankesa apo vërejtje për çështje të caktuara që janë në përgjegjësinë e Bashkisë. Këto struktura janë të detyruara t'i marrin në shqyrtim kërkesat, ankesat apo vërejtjet dhe të kthejnë përgjigje brenda afateve të përcaktuara me ligj

Kapitulli 6: Fazat dhe afatet e përgatitjes së buxhetit


Procesi i buxhetimit në nivel vendor në Shqipëri është i strukturuar dhe i rregulluar me ligj për të siguruar që paratë publike përdoren në mënyrë efektive dhe transparente. Çdo hap, nga planifikimi fillestar deri te vlerësimi i performancës, është i rregulluar me ligje specifike që synojnë të sigurojnë pjesëmarrjen e qytetarëve dhe menaxhimin e mirë të burimeve publike.

Procesi i buxhetit përfshin një seri hapash që synojnë ndarjen e burimeve për shërbime të ndryshme publike dhe projekte infrastrukturore. Programi i Buxhetit Afatmesëm (MTBP) shikon përpara për një periudhë prej tre deri në pesë vjet duke siguruar një strategji të qartë financiare, ndërsa Buxheti Vjetor fokusohet në detajet për vitin fiskal të ardhshëm. Parimet mbi të cilat mbështetet ky proces janë:




- **Transparencë:** Sigurimi që qytetarët janë të informuar për mënyrën se si ndahen fondet publike dhe si përdoren ato.
- **Llogaridhënie:** Sigurimi që zyrtarët publikë të jenë të përgjegjshëm për vendimet e tyre rreth foneve publike të cilat janë nën përgjegjësinë e menaxhimit të tyre
- **Efikasitet:** Ndarja e burimeve në një mënyrë që maksimizon përfitimin public nga përdorimi i këtyre fondeve

RRUGËTIMI PERIODIK VJETOR I BUXHETIT



- **Afati:** Dhjetor
- **Aktiviteti:** Këshilli vendor miraton një kalendar që përshkruan datat dhe aktivitetet kryesore për përgatitjen e MTBP dhe Buxhetit Vjetor.
- **Afati:** 31 Janar


- **Aktiviteti:** Kryetari i bashkisë i dorëzon këshillit një raport që përshkruan të ardhurat e pritshme për pesë vitet e ardhshme. Ky raport bazohet në udhëzimet ligjore dhe financiare.
- **Afati:** 1 Mars
- **Aktiviteti:** Këshilli shqyrton dhe miraton raportin e parashikimit të të ardhurave
- **Afati:** 15 Mars
- **Aktiviteti:** Miratohen tavanët paraprakë të buxhetit, duke përcaktuar kufijtë maksimalë të shpenzimeve për secilin program buxhetor.
- **Afati:** Maj
- **Aktiviteti:** Drafti i parë i MTBP përgatitet nga Kryetari dhe dorëzohet tek këshilli për shqyrtim dhe komente.
- **Afati:** Maj
- **Aktiviteti:** Këshilli organizon konsultime publike për të mbledhur mendime nga qytetarët mbi draftin e parë të MTBP dhe Buxhetin Vjetor.
- **Afati:** Maj
- **Aktiviteti:** Komentet nga konsultimet publike përfshihen në draftin e parë të MTBP, me ndryshimet e nevojshme të bëra në bashkëpunim me Kryetarin.
- **Afati:** 30 Qershor
- **Aktiviteti:** Këshilli miraton draftin e parë të MTBP, duke marrë parasysh komentet nga Ministria e Financave.
- **Afati:** 20 Korrik



- **Aktiviteti:** Miratohen tavanët finalë të shpenzimeve për MTBP në nivelin e programeve, duke siguruar disiplinë financiare.
- **Afati:** 10 Shtator
- **Aktiviteti:** Drafti i rishikuar i dytë i MTBP shqyrtohet dhe miratohet nga këshilli.
- **Afati:** Shtator
- **Aktiviteti:** Këshilli zhvillon raundin e dytë të konsultimeve publike mbi draftin e rishikuar të MTBP dhe Buxhetin Vjetor.
- **Afati:** Tetor
- **Aktiviteti:** Komentet nga raundi i dytë i konsultimeve publike përfshihen në draftin e rishikuar të MTBP.
- **Afati:** 30 Nëntor
- **Aktiviteti:** Drafti final i MTBP dorëzohet nga Kryetari për shqyrtim final nga këshilli.
- **Afati:** Dhjetor
- **Aktiviteti:** Drafti final i MTBP dhe Buxhetit Vjetor bëhet publik në faqen e internetit të bashkisë, duke siguruar transparencë.
- **Afati:** 25 Dhjetor
- **Aktiviteti:** Këshilli shqyrton dhe miraton versionin përfundimtar të MTBP dhe Buxhetit Vjetor, duke përmbyllur procesin e përgatitjes së buxhetit.



KUPTIMI SE KUSH ËSHTË PËRGJEGJËS PËR CDO HAP NË PROCESIN E BUXHETIT NDIHMON QYTETARËT TË DINË SE Ë KË TË KONTAKTOJNË ME PYETJE OSE SHQETËSIME



- **Kryetari i Bashkisë:** Mbikëqyr përgatitjen e buxhetit dhe dorëzon draftet në këshill.
- **Këshilli:** Shqyrton, amendon dhe miraton dokumentet e buxhetit.
- **Qytetarët:** Marrin pjesë përmes konsultimeve publike duke dhënë komente që mund të ndikojnë në vendimet buxhetore.

PJESËMARRJA E QYTETARËVE ËSHTË GUR THEMELI I NJË PROCESI BUXHETOR DEMOKRATIKE. JA SI MUND TË PËRFSHIHENI :

**JEPNI KOMENTE MBI
DRAFTET E BUXHETIT
PASI NË VETVETE
KY DOKUMENT DUHET
TË REFLEKTOJË NEVOJAT
E QYTETARËVE**

**MERRNI PJESË
NË SEANCAT
E KONSULTIMEVE
PUBLIKE SIPAS
KALENDARËVE
QË PUBLIKOHEN NGA
BASHKIA**

**QËNDRONI
TË INFORMUAR
PËRMES FAQES
SË INTERNETIT
TË BASHKISË DHE
KOMUNIKIMEVE TË
TJERA PUBLIKE**

Konkluzione

Procesi i buxhetit është një aspekt jetësor i qeverisjes qendrore dhe lokale, që ndikon në cilësinë e shërbimeve publike dhe infrastrukturës. Duke kuptuar dhe marrë pjesë në këtë proces, qytetarët mund të ndihmojnë në formësimin e së ardhmes së komunitetit të tyre.

Ky udhëzues është menduar të jetë një burim i plotë për qytetarët, duke e bërë procesin e buxhetit vendor më të qasshëm dhe të kuptueshëm. Duke u angazhuar me këtë proces, qytetarët mund të kontribuojnë në menaxhimin efektiv dhe transparent të burimeve të komunitetit.

Fjalorth

- **Buxheti i shtetit** – është një plan financiar që përmban propozimet e shpenzimeve dhe të të ardhurave të shtetit për një periudhë kohe të caktuar.
- **Projekt-buxhet** – plan paraprak i buxhetit i cili nuk është miratuar akoma nga institucionet përgjegjëse.
- **Institucion:** Organizëm shtetëror a shoqëror, që e zhvillon veprimtarinë e vet në një fushë të caktuar të ekonomisë, të shkencës, të arsimit, të kulturës, të jetës shoqërore, politike etj.
- **Institucion buxhetor:** Institucion që e kryen veprimtarinë e vet në bazë të një fondi vjetor të caktuar nga shteti.
- **Të ardhurat:** janë paratë që mbledh qeveria dhe që sigurohen kryesisht nga tatimet dhe taksat.
- **Shpenzimet:** janë para që përdoren nga qeveria për ofrimin e shërbimeve publike
- **Suficit buxhetor:** Kur të ardhurat e mbledhura nga qeveria tejkalojnë shpenzimet
- **Deficit buxhetor:** Kur shpenzimet buxhetore tejkalojnë të ardhurat e mbledhura
- **Programi Buxhetor Afatmesëm:** Plan 3-vjecar i shpenzimeve buxhetore të cilat duhet të reflektojnë politikat dhe prioritetet e qeverisë.
- **Këshilli i Ministrave:** Organi më i lartë i administratës shtetërore, që ka fuqi urdhërdhënëse e zbatuese
- **Kuvendi:** Është organi që gëzon pushtetin legjislativ si dhe ka detyrën të kontrollojë pushtetin ekzekutiv (qeverinë).
- **Buxheti Vjetor:** Plani buxhetor për vitin fiskal të ardhshëm.
- **Buxhet vjetor vendor:** sipas perkufizimit të mësipërm por i realizuar në nivel lokal (bashki)
- **Tavanët e Buxhetit:** Kufijtë maksimalë të përcaktuar për shpenzimet brenda programeve specifike të buxhetit.



**KY MANUAL REALIZOHET NË KUADËR TË PROJEKTIT
“ARTI GRAFIK PËR TRANSPARENCË DHE INFORMIM PUBLIK”
MË MBËSHTETJEN NGA SKEMA E GRANTEVE “BAT CIVIL SOCIETY”
E ZBATUAR NGA INSTITUTI PËR DEMOKRACI
DHE NDËRMJETËSIM NË PARTNERITET ME FAKTOJE
DHE CENTER FOR RESEARCH AND POLICY MAKING [CRPM],
MBËSHTETUR FINANCIARISHT NGA BASHKIMI EUROPIAN**

**Përgatitur dhe publikuar nga:
Qendra Durrësi Aktiv**



Budget
Accountability
and Transparency



Funded by
the European Union